



Mes ambicies dhe realitetit: formimi i ndërmarrjeve të reja publike lokale në Kosovë

Projekti "Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës" financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Mes ambicies dhe realitetit: formimi i ndërmarrjeve të reja publike lokale në Kosovë

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Arsyet e komunave për të themeluar ndërmarrje të reja publike	6
Kërkesat e komunave për krijimin e ndërmarrjeve të reja	8
Konsolidimi dhe kapaciteti i ndërmarrjeve të reja publike në komuna	11
Të hyrat dhe shpenzimet e ndërmarrjeve publike lokale dhe struktura e të punësuarve	12
Transparenca e ndërmarrjeve të reja publike në komuna	15
Ndërmarrjet publike lokale në vende të ndryshme	16
Trendet e qasjes ndaj NPL-ve në Bashkimin Evropian dhe vendet tjera	18
Përfundime dhe rekomandime	19

Përmbledhje ekzekutive

Shërbimet publike nëpër komuna në Kosovë organizohen në disa mënyra. Në pjesën më të madhe të komunave, shërbimi për menaxhimin e mbeturinave mbulohet nga ndërmarrjet publike rajonale, ndërkaq shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave dhe institucioneve publike mbulohen kryesisht nga operatorët privatë ose ndërmarrjet publike lokale (NPL). Aktualisht ekzistojnë 55 ndërmarrje publike lokale, ku 42 nga to janë të trashëguara nga periudha e paraluftës. Për shërbimet të cilat nuk i mbulojnë këto 42 ndërmarrje, komunat kryesisht kanë angazhuar operatorë privatë. Mirëpo, nga viti 2015, vërehet një qasje e komunave për të zhvendosur më shumë nga shërbimet e tilla nga operatorët privat tek ndërmarrjet publike lokale. Sipas komunave, arsye për këtë janë çmimet e larta të shërbimeve nga operatorët privatë, cilësia e dobët e shërbimeve, mos-zbatimi i kushteve të kontratës, etj. Deri më tani janë themeluar 13 ndërmarrje publike lokale dhe po ashtu gjashtë komuna të tjera kanë parashtruar kërkesë tek Qeveria e Kosovës për themelimin e ndërmarrjeve të reja, sipas legjislacionit në fuqi. Me themelimin e një NPL-je, komuna merr përsipër më shumë obligime se në rastin kur ka marrëveshje kontraktuale me operatorët privatë.

Marrë parasysh se performanca e ndërmarrjeve publike, qoftë të atyre qendrore, rajonale apo lokale, në vazhdimësi ka qenë jo e kënaqshme, nisma për të themeluar më shumë ndërmarrje do të duhej të shoqërohej me diskutime përmbajtësore, duke analizuar drejt përparësitë kundrejt bashkëpunimit me sektorin privat. Në Bashkimin Evropian vërehet një tendencë e rritjes së bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe atij privat në ofrimin e shërbimeve publike. Ndonëse, studimet nuk tregojnë për dallime të mëdha nga aspekti i kostove në mes të rasteve kur këto shërbime mbulohen nga sektori publik apo ai privat.

Nga analizimi i disa prej NPL-ve të themeluara, ky raport gjenë se edhe pas themelimit të tyre, disa komuna vazhdojnë të angazhojnë edhe operatorë privatë për të mbuluar shërbimet e njëjta. Sikurse në rastin e komunave të Graçanicës dhe Suharekës. Gjetjet tjera tregojnë se kërkesat e komunave për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale të reja nuk shoqërohen edhe me studime të detajuara të fizibilitetit, që të vlerësojnë mundësinë, aftësinë, sfidat dhe rreziqet të një nisme të tillë publike. Po ashtu, nga baza rregullative në fuqi që trajton NPL-të, specifikohet se komuna nuk menaxhon direkt me ndërmarrjen e krijuar dhe ndërmarrja duhet ndërtohet dhe përfaqësohet si subjekt i veçantë juridik. Të dhënat e analizuara tregojnë se në disa raste komunat i mbulojnë drejtpërdrejt disa shpenzime rrejdhëse të NPL-ve të themeluara.

Ngjashëm, nga analizimi i dokumenteve vërehet se komunat nuk kryejnë matje të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara, për të mbështetur argumentin e tyre se operatorët privatë nuk po arrijnë të ofrojnë shërbime cilësore. NPL-të e themeluara çalojnë ndjeshëm qoftë në kritere të ulëta të transparencës, por edhe në shkallën e ulët të punësimit të grave.

Hyrje

Ndërmarrjet publike në Kosovë që ofrojnë shërbime për komunat, në vazhdimësi përballen me vështirësi të mëdha operative dhe financiare. Për shërbimet tjera që nuk mbulohen nga ndërmarrjet rajonale, komunat deri më tani kanë kontraktuar kryesisht operatorë privatë. Por, sipas komunave, për shkak të shërbimeve jo cilësore, është e nevojshme që këto shërbime të kalojnë tek sektori publik, konkretisht ndërmarrjet publike lokale (NPL).

Kosova aktualisht ka 72 ndërmarrje publike. Numri më i madh i tyre apo 55 janë ndërmarrje publike/lokale, 11 janë ndërmarrje publike me shtrirje nacionale dhe 9 ndërmarrje rajonale.¹ Bazuar në legjislacionin aktual, vetëm Komuna e Prishtinës ka të drejtën, nëpërmjet Ligjit për kryeqytetin, që të themelojë ndërmarrje publike pa u konsultuar apo kërkuar aprovim nga niveli qendror.² Komunat e tjera duhet t'i nënshtrohen një sërë procedurash që lidhen kryesisht me arsyeshmërinë e kërkuar për krijimin e këtyre ndërmarrjeve.

Së fundmi, me vendim të Qeverisë së Kosovës, janë krijuar ndërmarrje publike lokale edhe në tri komuna: Podujevë, Suharekë dhe Kamenicë. Konkretisht, në fillim të tetorit të vitit 2023, Qeveria ka miratuar kërkesën e këtyre tri komunave për të pasur nën menaxhim ndërmarrjen "Eko-Llapi" në Podujevë, ndërmarrjen "Eko-Theranda" në Suharekë dhe ndërmarrjen "Dardana" në Kamenicë.³ Ndërkaq, në periudhën 2017-2022 janë themeluar ndërmarrje publike lokale sikurse "Eko Sig" në Pejë; "Ekologjia" në Graçanicë; "Omni Sport" në Mitrovicën e Jugut; "Tregu" në Gjilan; "Higjiena" në Deçan; "Përparimi" në Vushtrri; "Eko-Natyra" në Skënderaj; dhe "Kastrioti" në Obiliq.

Përveç këtyre, bazuar në Ligjin për kryeqytetin, në Prishtinë janë themeluar tri ndërmarrje të reja: "Prishtina Parking," "Kuzhina Qendrore" dhe "Pallati i Rinisë."

Në anën tjetër, gjashtë komuna të tjera (Lipjani, Shtërpca, Fushë Kosova, Gjakova, Juniku dhe Kaçaniku), kanë paraqitur kërkesat e tyre për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale të reja në Ministrinë e Ekonomisë në vitin 2022, dhe procedurat ende nuk kanë përfunduar.

Kriteret dhe procedurat për themelimin e këtyre ndërmarrjeve në nivel lokal janë përcaktuar me Rregulloren e Qeverisë së Kosovës të vitit 2013 për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale.⁴ Në mesin e kriterëve janë edhe që ndërmarrja duhet të ketë statusin e shoqërisë aksionare, ku komuna cakton komisionin e aksionarëve, i cili zgjedh dhe mbikëqyr bordin e drejtorëve dhe pastaj bordi i drejtorëve përzgjedh dhe mbikëqyr menaxhmentin ekzekutiv. Hapësira dhe asetet e ndërmarrjes duhet të jenë të siguruara nga themeluesi dhe në rastin e paraqitjes së kërkesës pranë Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë, duhet të prezantohet struktura e organizatës, plani i

¹ Ministria e Ekonomisë. Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Kërkesë për qasje në dokumente publike. 15.11.2022. Numri i ndërmarrjeve publike në Kosovë.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 06/I-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën.](#) Neni 7. Fq 2 & 3.

³ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. [Vendim](#) Nr. 07/165, datë: 12.10.2023.

[Vendim](#) Nr. 08/165, datë: 12.10.2023. [Vendim](#) Nr. 09/165, datë: 12.10.2023.

⁴ Qeveria e Kosovës. Rregullorja nr.02/2013 për Kriteret e Themelimit të Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe përfaqësimin në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit.

biznesit, plani i buxhetit që përfshin shpjegimet për qëndrueshmërinë ekonomike dhe operative të organizatës, si dhe kërkohet nënshkrimi i zotimit nga komuna për investime të ardhshme në ndërmarrjen që synon të krijojë.

Në këtë raport, bazuar në të drejtën për qasje në dokumente publike, Instituti GAP ka pranuar edhe shqyrtuar raportin e arsyeshmërisë dhe qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve të fundit të krijuara në Kamenicë, Podujevë dhe Suharekë. Po ashtu për nëntë ndërmarrje të tjera janë pranuar raportet vjetore financiare, plani i biznesit, lista e punëtorëve dhe lista e aseteve. Njëherazi janë shqyrtuar ligjet sistemore që mbulojnë ndërmarrjet publike dhe disa nga raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve, që bien në përgjegjësi të ndërmarrjeve publike lokale, nuk janë të publikuara nga këto ndërmarrje.

Arsyet e komunave për të themeluar ndërmarrje të reja publike

Komunat që kanë parashtruar kërkesa të Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP) në Ministrinë e Ekonomisë për themelimin e NPL-ve nuk kanë bërë në ndonjë rast studim fizibiliteti, i cili do të nënkuptonte një analizë thelbësore që synon të vlerësojë mundësinë, aftësinë, sfidat dhe rreziqet e suksesit të një nisme të tillë publike. Kjo, ndonëse nuk kërkohet me rregullativën ligjore, do të paraqiste rastin më të mirë të zberthimit edhe të nevojave, por edhe të prioriteteve dhe problemeve eventuale që do të dalin nga themelimi i një ndërmarrjeje të re publike.

Krahas kërkesës për themelim, komunat duhet të përfshijnë edhe një dokument lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës së parashtruar.⁵ Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga Instituti GAP, komunat ndjekin modele të ndryshme të përmbushjes së këtij kriteri. Në asnjë nga këto dokumente nuk prezantohet arsyeshmëria lidhur me nevojat e komunitetit apo sektorit në fjalë, si dhe nuk prezantohen mundësitë dhe rreziqet që mund të sjellë një NPL e re.⁶

Komunat në asnjë rast nuk kanë bërë vlerësim të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale të cilat synohen të mbulohen nga NPL-të e reja. Për më tepër, pretendimet e komunave që operatorët ekonomikë po i vonojnë punët dhe nuk po ekzekutojnë punë cilësore, në disa raste dalin të jenë në kundërtënie me gjetje të Zyrës Kombëtare të Auditorit, të cilat ngërthejnë vërejtje kundrejt vetë komunave dhe jo operatorëve privat që kontraktohen nga komunat.⁷

⁵ Qeveria e Kosovës. [Regullorja nr.02/2013 për Kriteret e Themelimit të Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe përfaqësimin në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit. Kriteret](#). Neni 4.

⁶ Raportet e arsyeshmërisë për krijimin e ndërmarrjes publike lokale. Komuna e Podujevës, Komuna e Suharekës dhe. Raporti i Arsyeshmërisë për Krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale. Komuna e Kamenicës; Dokumentacioni i pranuar nga kërkesa për qasje në dokumente publike.

⁷ Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raport i auditimit të përformancës](#). Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale. Fq 36

Po ashtu, në fazën e parashtrimit të kërkesave në qeveri për themelimin e NPL-ve nuk specifikohen objektet publike që ndërmarrja do të marrë në menaxhim. Po ashtu, nuk specifikohen potencialet teknike dhe njerëzore që komuna ka ose i duhen për të themeluar dhe funksionalizuar një ndërmarrje të tillë.

Qeveria e Kosovës, në pjesën e dytë të tetorit 2023, ka miratuar vendimin për themelimin e tri ndërmarrjeve të reja në Kamenicë, Suharekë, dhe Podujevë.⁸

Arsyet kryesore të paraqitura nga komunat te Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike janë: i) kosto e lartë e kryerjes së shërbimeve nëpërmjet operatorëve ekonomikë, ii) vonesa në kryerjen e punëve nga operatorët ekonomikë, iii) mungesa e cilësisë së punëve nga operatorët ekonomikë, iv) mundësi më e madhe për rritjen e përgjegjësisë, llogaridhënies dhe transparencës së punës nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes publike, v) mbulimi i disa shërbimeve njëkohësisht nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes publike, ose centralizimi i kryerjes së shërbimeve.

Arsyet e paraqitura nga komunat si mangësi ose vërejtje ndaj operatorëve privat që kanë kryer shërbime për komunën lidhen më shumë me kompetencat dhe problemet e brendshme të vetë komunave dhe jo me përgjegjësinë e operatorëve. Për shembull, vonesat në kryerjen e punëve janë të rregulluara përmes planit dinamik të punëve të komunave dhe bazuar në këtë plan, ata caktojnë një menaxher/e kontrate ose një komision vlerësues. Vlerësimet periodike nga Zyra Kombëtare e Auditimit tregojnë se në shumicën e rasteve, vonesat në kryerjen e punëve shkaktohen nga neglizhenca e vetë autoritetit kontraktues, papërgjegjësia e vetë komisionit vlerësues ose faktorë të tjerë që i ka shkaktuar ose nuk i ka shmangur vetë autoriteti kontraktues.⁹

I njëjti argument qëndron te arsyetimi se nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes publike, do të rritet cilësia e punëve. Sipas gjetjeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit, mungesa e cilësisë së punëve me shumë percillet te sfera e investimeve kapitale dhe jo aq e theksuar të sfera e shërbimeve, ndërsa të gjitha kërkesat që komunat kanë parashtruar për themelimin e ndërmarrjeve publike i takojnë natyrës së shërbimeve.¹⁰

Dokumenetet bazë që e rregullojnë çështjen e themelimit të ndërmarrjes publike, si Ligji për ndërmarrjet publike dhe Rrregullorja mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale, përveç saktësimin se komunat duhet të paraqesin arsyeshmërinë për krijimin e NPL-ve, nuk precizohet se çka duhet të përmbajë arsyeshmëria. Mungesa e kësaj ka bërë që përmbajtja e arsyeshmerisë për krijimin e NPL-së të jetë e ndryshme, varësisht nga komuna.

8 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. [Vendim](#) Nr. 07/165 Datë: 12.10.2023. [Vendim](#) Nr. 08/165 Datë: 12.10.2023. [Vendim](#) Nr. 09/165 Datë: 12.10.2023.

9 Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raport i auditimit të përformancës](#). Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale. Fq 36.

10 Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raport i auditimit të përformancës](#). Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale. Fq 36.

Kërkesat e komunave për krijimin e ndërmarrjeve të reja

Komunat, si njësi që e përbëjnë qeverisjen lokale në vend, përjashtuar Komunën e Prishtinës, nuk kanë të drejtë të themelojnë ndërmarrje të reja publike pa vendim nga Qeveria e Kosovës. Kjo saktësohet me Ligjin për ndërmarrjet publike.¹¹ Ndërsa te rasti i Komunës së Prishtinës, kjo çështje është rregulluar përmes Ligjit për kryeqytetin, ku saktësohet se kryeqyteti, sipas nevojës, themelon dhe menaxhon ndërmarrje publike lokale që shërbejnë vetëm për territorin e Prishtinës. Nisma dhe procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike lokale të kryeqytetit nuk kërkojnë marrjen e pëlqimit nga Qeveria.¹²

Në anën tjetër, komunat tjera ndjekin procedura të tjera. Komunat i nënshtrohen rregullores së vitit 2013 e cila është fuqizuar nga Qeveria e Kosovës, e cila përcakton kriteret dhe procedurat se si mund të themelohet një ndërmarrje e re lokale publike.¹³ Në mesin e kriterëve janë:

- Parashtrimi i kërkesës bëhet duke specifikuar se ndërmarrja do të ketë karakterin e shoqërisë aksionare, ku 100% të aksioneve i bart komuna që parashtron kërkesën për themelimin të ndërmarrjes.
- Kapitali fillestar i themelimit të NPL-së duhet të jetë jo më pak se 10,000 euro.
- Ndërmarrja, pas themelimit ka statusin e personit juridik dhe është e ndarë dhe e veçantë nga aksionari i saj (komuna).
- Pas themelimit të NPL-së, komuna nuk ka autorizim për të menaxhuar dhe qeverisur ndërmarrjen.
- Ndërmarrja qeveriset nga bordi i drejtorëve, drejtori ekzekutiv ose menaxhmenti. Komuna ushtron kontroll mbi ndërmarrjen përmes komisionit të aksionerëve që e cakton kryetari/ja i/e komunës së bashku me kuvendin komunal
- Selia kryesore e ndërmarrjes publike lokale duhet të jetë në territorin e komunës në të cilën themelohet.
- Hapësirat punuese dhe pajisjet teknike për funksionimin normal dhe ofrimin e mjaftueshëm të shërbimeve publike ndaj qytetareve duhet të jenë të siguruara nga themeluesi.
- Komuna para se të adresojë kërkesën te Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në Ministrinë e Ekonomisë duhet të paraqesë një raport për qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes publike.
- Raporti për arsyeshmerinë e krijimit të ndërmarrjes (ku përfshihen struktura organizative, plani i biznesit dhe plani i buxhetit)
- Komunat duhet të garantojë me shkrim për investime të ardhshme për qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes publike lokale.

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji për Ndërmarrjet Publike](#). Neni 11.

12 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës](#), Prishtinë. Neni 7, pika 1.3.

13 Qeveria e Kosovës. [Rregullorja nr.02/2013 për Kriteret e Themelimit të Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Përfaqësimin në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit](#). Kriteret. Neni 4.

- Pas paraqitjes së kërkesës tek NJPMNP, kjo njësi, në afatin prej 30 ditë pune, fillon procedurat e shqyrtimit për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale. Nëse nuk ka ndonjë kundërshtim, atëherë kjo njësi e procedon dokumentacionin së bashku me kërkesën e komunes për themeluar NPL të Komisioni Ministror për Ndërmarrjet Publike. Nëse Komisioni Ministror konstaton se janë plotësuar kriteret, i rekomandon qeverisë themelimin e ndërmarrjes publike lokale.

Bazuar në këto kritere, 13 komuna të Kosovës kanë themeluar ndërmarrje publike, pas aprovimit të kërkesës së tyre në qeveri. Këto komuna janë: Deçani, Peja, Gjakovë, Podujeva, Gjilani, Kamenica, Graçanica, Suhareka, Ferizaj, Klina, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Vushtria, Rahoveci dhe Komuna e Skenderajt.¹⁴

Ndërsa, gjashtë komuna të tjera (Lipjani, Shtërpca, Fushë Kosova, Gjakova, Juniku dhe Kaçaniku) kanë paraqitur kërkesat e tyre për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale pranë Ministrisë së Ekonomisë, dhe akoma procedurat mbesin të hapura.

Tabela 1. Lista e komunave që kanë paraqitur kërkesë për themelimin të ndërmarrjes dhe nëse të njejtat janë aprovuar si të bazuara nga qeveria dhe funksioni për të cilin janë themeluar.¹⁵

Komuna	Emri i ndërmarrjes	Viti kur është paraqitur kërkesa	Viti kur është aprovuar/votuar kërkesa në qeveri	Për cilin funksion është kërkuar/themeluar ndërmarrja
Deçani	"Higjiena"	2015	2019	Menaxhimi mbeturinave/hapësirave publike
Peja	"Eko Sig"	2021	2022	Mirëmbajtja e hapësirave publike/varrezave dhe parqeve/sigurimi i objekteve publike/administrative.
Podujeva	"Eko Llapi"	2022	2023	Mirëmbajtja e hapësirave publike/varrezave dhe parqeve/mirëmbajtja e shtratit të lumit.
Gjilani	"Tregu"	2015	2017	Menaxhimi i hapësirave të tregut të gjelbërt, tregut të automjeteve dhe tregut të kafshëve.
Kamenica	"Dardana"	2022	2023	Mirëmbajtja e hapësirave publike/varrezave dhe parqeve/parqeve dhe objekteve publike.
Graçanica	"Ekologia"	2015	2017	Mirëmbajtja dhe menaxhimi i mbeturinave, kanalizimit, hapësirave publike, parqeve dhe shtratit të lumit.

¹⁴ Lista e komunave që kanë paraqitur ose themeluar NPL është evidentuar përmes vendimeve të qeverisë, nga përgjigjet e marra nga Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë si dhe nga të dhënat e paraqitura nga Komunitat e Kosovës.

¹⁵ Lista e ndërmarrjeve të paraqitura në tabelë është evidentuar përmes vendimeve të Qeverisë së Kosovës nga 2015 deri në nëntor 2023, nga përgjigjet e pranuar nga Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë.

Komuna	Emri i ndërmarrjes	Viti kur është parashtruar kërkesa	Viti kur është aprovuar/ votuar kërkesa në qeveri	Për cilin funksion është kërkuar/themeluar ndërmarrja
Suhareka	"Eko Theranda"	2020	2023	Mirëmbajtja e hapësirave publike/ parqeve/ objekteve publike.
Ferizaj	"Ambienti"	2015	2016	Mirëmbajtja e hapësirave publike/varrezave dhe parqeve
Mitrovica e Jugut	"Omni Sport"	2015	2017	Menaxhimi i objektit rekreativo/ sportivë.
Obiliqi	"Kastrioti"	2017	2021	Mirëmbajtja e hapësirave publike/varrezave dhe parqeve
Vushtrria	"Përparimi"	2018	2020	Menaxhimi mbeturinave/ hapësirave publike
Rahoveci	"Stacioni i Autobusëve"	2018	2019	Menaxhimi i linjave të autobusëve në ardhje dhe vajtje.
Skenderaj	"Eko Natyra"	2018	2020	Menaxhimi mbeturinave/ hapësirave publike

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të themeluara, duke përjashtuar atë të "Omni Sport" në Mitrovicën e Jugut dhe "Tregun" në Gjilan, kanë si detyrë mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave dhe parqeve, si dhe mirëmbajtjen e objekteve publike. Para se të themeloheshin këto ndërmarrje, këto aktivitete, në pjesën më të madhe të rasteve, ishin të mbuluara nga operatorët ekonomikë, përmes kontratave të prokurimit publik.

E vetmja komunë së cilës i është refuzuar kërkesa për të krijuar ndërmarrje publike ka qenë ajo e Junikut. Kjo ka ardhur ngase në specifikat e statutit të kësaj ndërmarrje është paraparë që e njëjta të menaxhojë edhe me burimet ujore dhe ujësjellesin, e cila është kompetencë e rezervuar për ndërmarrjet rajonale që janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Kjo komunë ka parashtruar sërish kërkesë në NJPMNP gjatë muajit nëntor të këtij viti për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, e cila do të fokusohet në menaxhim të mbeturinave, hapësirave publike, ndërtesave administrative si dhe ndriçimit publik.¹⁶

¹⁶ Komuna e Junikut. Drejtoria e Shërbimeve Publike. Intervistë. Demokrat K. Ganiqaj. 17.11.2023.

Konsolidimi dhe kapaciteti i ndërmarrjeve të reja publike në komuna

Sfidat më të mëdha që shoqërojnë komunat pas aprovimit të kërkesës së tyre në qeveri për themelimin e një ndërmarrjeje publike janë të lidhura me procesin e konsolidimit të kësaj ndërmarrjeje. Kjo fazë përfshin caktimin e objektit (zyreve) të ndërmarrjes së re, blerjen e pajisjeve dhe makinave për të kryer funksionin për të cilin është themeluar ndërmarrja, zgjedhjen e bordit, drejtorit/es ekzekutiv/e, komisionit të aksionerëve, punësimin e stafit në përputhje me mandatin e ndërmarrjes, regjistrimin e pronës në emër të ndërmarrjes dhe pjesët tjera operative si hartimi i statutit të ndërmarrjes, planit të biznesit, organogramit, faqes së internetit, pastaj krijimi i praktikave të menaxhimit dhe hartimi adekuat i raporteve të punës dhe financiare periodike dhe vjetore.

Nisur nga vlerësimi i aseteve të ndërmarrjeve publike lokale të krijuara viteve të fundit, vihet në pah se potenciali i të njëjtave për të ofruar ose garantuar cilësi të shërbimeve është tejet i kufizuar.

Në ndërmarrjen publike "Eko Natyra" në Skënderaj, vlera e gjithë makinerive të punës, përfshirë edhe automjetet, kap vlerën e më pak se 31,000 euro.¹⁷ Kjo ndërmarrje nuk ka të regjistruar në emër të saj ndonjë zyre, objekt apo pronë dhe nuk ka kryer asnjë investim kapital në dy vitet e fundit 2022 dhe 2021. Ndërmarrja nuk figuron të ketë bërë shpenzime komunale (rrymë, ujë, mbeturina, telefoni fikse) që tregojnë se shpenzimet e kësaj natyre mbulohen direkt nga komuna, njësoj siç komuna i mbulon këto lloj shpenzime për shkolla dhe qendra mjekësore. Por, një praktikë e tillë bie ndesh me Rregulloren e qeverisë të vitit 2013 ku specifikohen kriteret e themelimit të ndërmarrjeve të reja publike në komuna. Në këtë rregullore specifikohet se komuna nuk menaxhon direkt me ndërmarrjen e krijuar dhe ndërmarrja duhet të ndërtohet dhe përfaqësohet si subjekt i veçantë juridik.¹⁸

Ndërkaq, kompania tjetër publike në Pejë "Eko Sig" ka në dispozicion dy kamioneta dhe nuk ka paraqitur se ka asete të tjera.¹⁹ Te kompania "Higjiena" në Deçan, vlera e përgjithshme e aseteve që i ka ndërmarrja në dispozicion, përfshirë edhe inventarin arrin shumën e 192,500 euro, vlerë kjo e përafërt që në dispozicion ka edhe kompania tjetër publike lokale në Obiliq "Kastrioti". Ndërsa kompania "Tregu" në Gjiilan ka të paraqitura asete në vlerë më pak se 9,000 euro.²⁰

¹⁷ "Eko Natyra". Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Skenderajt. Lista e Aseteve.

Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

¹⁸ Qeveria e Kosovës. Rregullorja nr.02/2013 për Kriteret e Themelimit të Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe përfaqësimin në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit. Kriteret. Neni 6.

¹⁹ Eko Sig". Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Pejës. Lista e Aseteve.

Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²⁰ "Higjiena". Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Deçanit. Lista e Aseteve.

Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

Bazuar në asetet në dispozicion, ndërmarrjet që kanë paraqitur kapacitet të mirë operues janë "Prishtina Parking", ndërmarrja "Kuzhina Qendrore", në Prishtinë dhe ndërmarrja "Ekologia" në Graçanicë. "Prishtina Parking" ka paraqitur një listë të asetëve që përfshin automjete, kamera, laura, rroba dhe inventar. E njëjta është hasur edhe te ndërmarrja "Kuzhina Qendrore" dhe "Ekologia".²¹

Komunat, pavarësisht krijimit të ndërmarrjeve publike lokale me qëllim që të njëjtat t'i mbulojnë shërbimet që deri vonë i kanë kryer operatorët privatë, po vazhdojnë t'u japin tenderë edhe kompanive private për të njëjtat shërbime. Ndonëse ka afro katër vite që funksionon ndërmarrja "Ekologia", gjatë vitit 2022, Komuna e Graçanicës ka lidhur kontratë me një operator privat me qëllim të kryerjes së shërbimeve për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve.²² E njëjta është hasur në Komunën e Suharekës. Në periudhen kur kjo komunë ka parashtruar kërkesë në qeveri për të themeluar NPL që si objektivë parësore e ka vendosur mirëmbajtjen e hapësirave publike duke përfshirë edhe largimin e deponive të mbeturinave, ka lidhur kontratë me një operator privat në kohëzgjatje për një vit për trajtimin e deponive ilegale.²³

Pesë vite pasi Ferizaj e ka krijuar NPL "Ambienti", në vitin 2022 ka lidhur kontratë me operatorë privatë për rregullimin i hapësirave të gjelbra, shesheve, rrugëve e nënkalimeve në qytet si dhe mirëmbajtjen e tyre.²⁴

Nga ana tjetër, ndonëse komunat marrin shërbime dhe bëjnë pagesa për ndërmarrjet që i kanë krijuar, në të njëjtën kohë japin subvencione për to. Komuna e Prishtinës ka paguar shërbime, ushqim për çerdhe, ndaj NPL "Kuzhina Qendrore" në vlerë prej 611,268 euro për vitin 2022, dhe në të njëjtin vit ka dhënë subvencione për këtë ndërmarrje në vlerë prej 30,000 euro.²⁵

Të hyrat dhe shpenzimet e ndërmarrjeve publike lokale dhe struktura e të punësuarve

Performanca e mirë e NPL-ve lidhet direkt me aftësinë dhe mundësinë e këtyre subjekteve që të ofrojnë shërbime cilësore, të shpejta dhe të lira për qytetarët, në njërën anë, dhe në anën tjetër, me menaxhimin/planifikimin e mirë financiar, vendimmarrje të bazuar në frymën e transparencës dhe ligjshmërisë si dhe kapacitetin investues të ndërmarrjes.

²¹ Dokumentacion i pranuar nga këto tri ndërmarrje lidhur me asetet në dispozicion. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²² Komuna e Graçanicës. [Kontratë për Shërbime](#), 2022.

²³ Komuna e Suharekës. [Kontratë për Shërbime](#), 2022.


²⁴ Komuna e Ferizajt. [Kontratë për Shërbime](#), 2022.

²⁵ Komuna e Prishtinës. [Raporti financiar janar-dhjetor](#) 2022. Fq 30.

Nisur nga kjo e fundit, asnjëra nga ndërmarrjet e reja të krijuara, nuk po arrijnë që të realizojnë investime kapitale, siç është ndërtimi i zyreve (objekteve), ndërsa për shumicën e tyre ka qenë e papërballueshme financiarisht që të blejnë paisje për të përmbushur misionin për të cilën janë krijuar.

Nga analizi i të dhënave të performancës financiare të ndërmarrjeve publike lokale, del se shumica arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet e tyre. Kjo është edhe e pritshme marr parasysh që komunat sigurohen që NPL-të të jenë funksionale, meqë edhe janë krijuar me vetë nismën e tyre.

Figura 1. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2022 të disa nga NPL-të e themeluara



Burimi: Raportet financiare të ndërmarrjeve të përfshira në graf të pranuar nga kërkesa për qasje në dokumente publike.

Nëse analizohet struktura e shpenzimeve të këtyre ndërmarrjeve, vërehet se shumica nga to shpenzojnë më së shumti për paga. Ndërmarrja "Tregu" në Gjilan, 86% e mjeteve i dedikon në paga, ndërmarrja "Kastrioti" 80%, ndërmarrja "Eko Natyra" 71%, "Kuzhina qendrore" 66%, ndërmarrja "Ekologia" 56%, ndërmarrja "Higjiena" 52%, ndërmarrja "Pallati i Rinisë" 49%.²⁶

Numri i të punësuarëve në disa nga ndërmarrjet publike lokale tejkalon edhe numrin e të punësuarëve që kanë komunat si njësi e veçantë e qeverisjes lokale. Si shërbyes civilë, Komuna e Pejës ka të punësuar 241 persona, përderisa ndërmarrja e krijuar nga kjo komunë i ka paraqitur 279 të punësuar, ku hyjnë edhe të punësuarit si mirëmbajtës higjienik dhe teknik të disa shkollave dhe të qendrave administrative. Komuna vazhdon t'i paguajë këta persona, ndërsa menaxhimin e tyre e bën ndërmarrja "Eko Sig".²⁷ Komuna e Gjilanit ka të punësuar 352 shërbyesë civilë, përderisa ndërmarrja "Tregu" në këtë komunë ka 264 persona të punësuar.²⁸ Ndërsa në Komunën e Graçanicës, si shërbyes civilë në komunë janë të punësuar 72 persona, përderisa në ndërmarrjen publike të themeluar nga kjo komunë të punësuar


²⁶ Dokumentacion i pranuar (lista e punëtorëve dhe e pagave) nga këto ndërmarrje. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²⁷ "Eko Sig". Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Pejës. Lista e të punësuarëve. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²⁸ "Tregu". Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Gjilanit. Lista e të punësuarëve. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

janë 127 persona.²⁹ Numër i lartë i personave të punësuar hasen edhe në ndërmarrjen “Pallati i Rinisë” në Prishtinë dhe kjo ekziston edhe përkundër që kjo ndërmarrje një numër të madh të shërbimeve i kontraktin përmes operatorëve privatë.³⁰


Figura 2. Numri i të punësuarëve në disa nga ndërmarrjet publike lokale



Burimi: Lista e të punësuarëve të ndërmarrjeve të përfshira në graf janë të dhëna të pranuar nga kërkesa për qasje në dokumente publike.

Të dhënat e punësimit sipas gjinisë në këto ndërmarrje publike lokale tregojnë për ekzistimin e një hendeku të theksuar mes punësimit të burrave dhe grave. Në ndërmarrjen “Higjiena” nga 53 persona të punësuar, vetëm pesë (9.4%) janë gra, ose në ndërmarrjen “Kastrioti” nga 53 të punësuar vetëm 9 (17%) prej tyre janë gra. Hendek i madh mes burrave dhe grave në punësim haset edhe në Graçanicë të ndërmarrja “Ekologjia”, ku nga 127 persona të punësuar, vetëm 16 janë gra (12.6%).

Figura 3. Ndarja e të punësuarëve sipas gjinisë



Burimi: Lista e të punësuarëve të ndërmarrjeve të përfshira në graf janë të dhëna të pranuar nga kërkesa për qasje në dokumente publike.

²⁹ “Ekologjia”. Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Graçanicës. Lista e të punësuarëve. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

³⁰ “Pallati i Rinisë”. Ndërmarrje Publike Lokale. Komuna e Prishtinës. Lista e të punësuarëve. Dokumentacion i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

Transparenca e ndërmarrjeve të reja publike në komuna

Për të arritur transparencën në ndërmarrjet publike lokale në Kosovë është e rëndësishme të përfshihen disa elemente kyçe. Fillimisht, ndërmarrjet publike lokale duhet të publikojnë informacionet financiare të tyre në mënyrë të hapur dhe të qartë. Kjo përfshin buxhetin, shpenzimet, të ardhurat, dhe të dhëna të tjera financiare që mund të jenë me interes për opinionin. Të rëndësishme janë edhe publikimi i vendimeve të organeve vendimarrëse, veçmas ato që lidhen me kontrata, investime dhe takime me interes për ndërmarrjen dhe opinionin.

Të rëndësishme për imazhin dhe funksionimin e ndërmarrjes janë edhe raportet e auditimit, publikimi i të cilave e bënë ndërmarrjen të demostrojë nivel të duhur të llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Ndërmarrjet e reja duhet të parashohin edhe format e komunikimit me qytetarë, që këta të fundit të arrijnë t'i paraqesin ankesat dhe kërkesat e tyre. Nisur nga këto, tabela e mëposhtme vlerëson NPL-të nëse kanë nivel të duhur të qasjes dhe informacionit financiar dhe operativ.

Tabela 2. Niveli i transparencës së NPL-ve vlerësuar nga ekzistimi i faqeve zyrtare në internet dhe informacioneve të publikuara në këto faqe.

Ndërmarrja	A posedon ndërmarrja uebfaqe	Raporti financiar gjashtë mujor (2023)	Raporti financiar vjetor (2022)	Aktivitetet e ndërmarrjes	Të dhënat se kush e përfaqëson bordin, kryeshefin/en	Numri i kontakteve për paraqitjen e vërejtjeve/kërkesave përfshirë edhe në rrjetet sociale
NPL "Higjena" Deçan	✓	✗	✓	✓	✓	✓
NPL "Eko Natyra" Skenderaj	✗	✗	✗	✗	✗	✓
NPL "Tregu" Gjilan	✗	✗	✗	✗	✗	✗
NPL "Qendra Multifunkionale" Mitrovicë" Omni Sport.	✓	✗	✗	✗	✗	✓
NPL "Perparimi" Vushtrri	✗	✗	✗	✗	✗	✗
NPL "Kastrioti" Obiliq	✓	✗	✓	✓	✗	✓
NPL "Stacioni i Autobusëve" Rahovec	✗	✗	✗	✗	✗	✗
NPL "Ekologjia" Graçanicë	✓	✗	✗	✗	✗	✗
NPL "Prishtina Parking"	✓	✗	✗	✓	✓	✓
NPL "Kuzhina Qendrore"	✓	✗	✗	✓	✓	✓
NPL "Pallati i Rinisë"	✓	✗	✗	✓	✗	✓

Vlerësimi në këto uebfaqe është bërë në javën e katërt të muajit nëntor 2023.

Nga 11 ndërmarrje publike lokale të përfshira në këtë tabelë rezulton se katër nga këto nuk kanë faqe zyrtare në internet, gjë e cila u pamundëson qytetarëve dhe palëve të interesit që të kuptojnë ekzistencën e këtyre ndërmarrjeve dhe veprimtarinë që të njëjtat ushtrojnë. Për më shumë, asnjëra nga to nuk i ka të publikuara raportet gjashtë mujore të të hyrave dhe shpenzimeve. Ndërsa raportin vjetor financiar e publikojnë vetëm dy nga këto 11 ndërmarrje (ndërmarrja "Higjiena" në Deçan dhe "Kastrioti" në Obiliq). Nga shtatë ndërmarrje publike që janë të paraqitura në tabelë, që posedojnë faqe zyrtare në internet, pesë nga to nuk i kanë të paraqitura as informatat themelore në lidhje me misionin ose qëllimin që ka ndërmarrja përkatëse. Tetë ndërmarrje nuk i kanë të publikuara as të dhënat se kush e udheheq/menaxhon ndërmarrjen. E vetmja fushë e cila ka dalur të ketë vlerësim më pozitiv është hasja e numrave të telefonit dhe emailave zyrtar të këtyre ndërmarrjeve (tetë nga 11 ndërmarrje) dhe kjo kryesisht haset në faqet e këtyre ndërmarrjeve në rrjetin social "Facebook".

Duke u nisur nga këto përshkrime, niveli i përgjithshëm i transparencës në ndërmarrjet publike lokale të përfshira në këtë analizë vlerësohet të jetë i ulët. Mungesa e informacionit kyç dhe dokumentacionit financiar e bënë të vështirë për publikun dhe palët e tjera të monitorojnë dhe vlerësojnë efikasitetin dhe integritetin e veprimtarisë së këtyre ndërmarrjeve.

Ndërmarrjet publike lokale në vende të ndryshme

Ngjashëm si në Kosovë, detyrat kryesore të ndërmarrjeve publike lokale në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe më gjerë përfshijnë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike, si mirëmbajtja e infrastrukturës dhe shërbimeve komunale të tilla si ujë, ujërave të zeza, grumbullimit të mbeturinave, organizimit të transportit publik lokal, shpërndarjen e energjisë elektrike etj. Aktivitetet specifike dhe sektorët në të cilët përfshihen NPL-të mund të ndryshojnë në bazë të shtetit dhe shkallës së decentralizimit të tij, si dhe shtrirjes dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve publike të deleguara në nivelin e qeverisjes lokale.³¹

Në shumicën e vendeve në Evropë, numri i ndërmarrjeve publike lokale nuk del të jetë i lartë. Në shumë nga to, në mesatare, ka më pak ndërmarrje publike lokale sesa komuna. Në tabelën 3, paraqitet numri i komunave dhe numri i NPL-ve në vende të ndryshme. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të kuptuar organizimin territorial dhe nivelin e aktivitetit ekonomik të NPL-ve në secilin shtet.

³¹ Chaire Economie des Partenariats Public-Privé Institut d'Administration des Entreprises.
[Local Public Enterprises: A Taxonomy.](#)

Për shembull, në Francë, numri i komunave është shumë i madh (36,565), mirëpo numri i ndërmarrjeve publike lokale është 1,198. Sllovenia ka 193 komuna por vetëm 60 NPL, Portugalia ka mbi 4,000 komuna por vetëm 60 NPL, Belgjika ka 589 komuna dhe 243 NPL, Gjermania ka rreth 14 mijë komuna dhe 3,500 NPL, etj.

Tabela 3. Numri i komunave dhe NPL-ve në vende të ndryshme

Shteti	Numri i Komunave	Numri i NPL-ve	NPL / Nr. Komunave
Japonia	1,727	9,379	5.43
Gjermania	13,854	3,500	0.25
Polonia	2,489	2,415	0.97
Suedia	290	1,750	6.03
Franca	36,565	1,198	0.03
Greqia	900	1,116	1.24
Italia	8,101	963	0.12
Finlanda	448	944	2.11
Spanja	8,106	770	0.09
Latvia	547	669	1.22
Republika Ceke	6,258	339	0.05
Korea e Jugut	232	306	1.32
Zelanda e Re	85	257	3.02
Belgjika	589	243	0.41
Slovakia	2,920	239	0.08
Danimarka	275	224	0.81
Estonia	247	224	0.91
Mbretëria e Bashkuar	326	185	0.57
Austria	2,359	149	0.06
Portugalia	4,037	76	0.02
Sllovenia	193	60	0.31

Burimi: Chaire Economie des Partenariats Public-Privé Institut d'Administration des Entreprises

Trendet e qasjes ndaj NPL-ve në Bashkimin Evropian dhe vendet tjera

Trendet kryesore globale në qasjen ndaj NPL-ve përfshijnë korporatizimin dhe përfshirjen e sektorit privat. Korporatizimi paraqet një zhvendosje nga modeli tradicional i ofrimit të shërbimeve publike nga NPL-të, që operonin brenda autoritetit publik, drejt një modeli hibrid midis firmave publike dhe private. Ky proces ka për qëllim transferimin e të drejtave në lidhje me vendimet menaxheriale ngazyrtarët publik tek menaxherët, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti dhe fleksibiliteti në ofrimin e shërbimeve publike.³²

Nga ana tjetër, përfshirja e sektorit privat nënkupton një sërë marrëveshjesh, nga kontraktimi deri te partneritetet publiko-private dhe krijimin e ndërmarrjeve publike të përziera, ku në shumicën e rasteve në to ekziston një pronësi më e madhe publike për të siguruar peshën e interesit publik në marrjen e vendimeve. Kontraktorët privat luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike, veçanërisht në rastet kur sektori publik kërkon të shfrytëzojë ekspertizën, burimet dhe efikasitetin e sektorit privat. Përfshirja e kontraktorëve privatë mund të variojë nga kontratat tradicionale të prokurimit dhe kontraktimi i detyrave të brendshme deri te marrëveshjet më të gjera të kontraktimit dhe partneriteteve publike-private (PPP).³³

Studimet empirike kanë treguar se nuk ka dallim të madh në kostot e veprimit midis NPL-ve dhe firmave private që ofrojnë shërbime. Ndërsa, potenciali për përfitime të efikasitetit përmes pjesëmarrjes së sektorit privat jo rrallë herë mund të jetë i kufizuar në disa sektorë.³⁴ Si përfundim, nuk ka një avantazh të qartë për sa i përket efikasitetit të performancës ndërmjet NPL-ve dhe kontraktorëve privat. Pra, zgjedhja midis NPL-ve dhe kontraktorëve privat varet nga konteksti specifik dhe qëllimet strategjike të qeverisë.

³² Ibid.

³³ Ibid.

³⁴ Ibid.

Përfundime dhe rekomandime

Deri më tani është diskutuar shumë pak në shoqëri lidhur me performancën, rolin dhe rëndësinë e ndërmarrjeve publike lokale në Kosovë. Komunitat, duke e shfrytëzuar mundësinë ligjore, kanë rritur kërkesën për të themeluar ndërmarrje të tilla. Nëpërmjet themelimit të NPL ato po synojnë t'i mbulojnë shërbimet që aktualisht ofrohen nga operatorët privatë. Ndonëse komunitat kanë për synim rritjen e efikasitetit të shërbimit dhe efikasitetit të parashërbimeve publike, nga procesi i themelimit e deri në futjen e tyre në operim, NPL-të po shoqërohen me disa probleme. Përfshi këtu mungesën e studimeve të fizibilitetit, për të arsyetuar në detaje sesi NPL do të operojë suksesshëm, e deri të mos arrijta e këtyre NPL të kryejnë tërësisht obligimet që i marrin përsipër. Për çka disa komuna të cilat kanë themeluar NPL, po angazhojnë kapacitete shtesë nga sektori privat për të mbuluar shërbimet.

Instituti GAP rekomandon që:

- Qeveria e Kosovës të plotësojë dhe ndryshojë rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale, me qëllim të sqarimit të kriterëve mbi të cilat komunitat paraqesin kërkesë për themelimit të ndërmarrjeve. Aktualisht rregullorja kërkon paraqitjen e një raporti lidhur me arsyeshmerinë për krijimin e ndërmarrjes, por nuk precizohet se çka duhet të përmbajë një arsyeshmëri e tillë. Si bazë do të duhet të përfshinte një studim lidhur me mundësitë, aftësitë, sfidat, rreziqet, dobësitë dhe përparësitë e një nismeje të tillë publike.
- Komunitat të cilat synojnë të krijojnë NPL duhet të sigurohen që kanë në dispozicion burime të nevojshme profesionale dhe financiare për të përmbushur një kërkesë të tillë.
- Komunitat duhet të heqin dorë nga praktika që në njërin anë të themelojnë NPL, e pastaj të marrin përsipër shërbime edhe nga operatorët privatë, meqë kjo shkakton kosto shtesë.
- Komunitat duhet të nisin procesin e pronësisë së NPL. Në shumicën e dërrmuese të ndërmarrjeve të paraqitura në analizë nuk ekziston pronësia e definuar e ndërmarrjeve.
- Komisioni i akcionerëve që caktohet nga Kuvendi Komunal duhet të jetë me aktiv në paraqitjen e raporteve të detajuara para kuvendit që lidhen me aktivitetet dhe projektet që ka NPL dhe në të njëjtën kohë të bëjë vlerësim të duhur e profesional lidhur me performancën e ndërmarrjeve, duke mos anashkaluar edhe problemet dhe ngecjet që kanë këto ndërmarrje.
- NPL-të duhet të fillojnë ta bëjnë praktikë në menaxhimin e tyre matjen e opinionit publik në fushat për cilat ofrojnë shërbime. Ky del edhe obligim nga Ligji për ndërmarrjet publike. Kjo do të paraqiste mundësi të mirë për të vlerësuar performancën operacionale të këtyre ndërmarrjeve.
- NPL-të duhet të rrisin nivelin e transparencës. Kjo përfshin azhurnimin e të dhënave mbi baza ditore lidhur me aktivitetet e kryera, në të njëjtën kohë duhet të publikohen të dhënat lidhur me të hyrat dhe shpenzimet financiare, lidhur me raportet e auditimit si dhe të paraqiten informatat që kanë të bëjnë me menaxhmentin, bordin e drejtorëve, komisionin e akcionerëve dhe po ashtu NPL-të duhet të publikojnë kontaktet e duhura që mund të shfrytëzohen nga palët e jashtme qoftë për kërkesa ose ankesa.

Analizë

Mes ambicies dhe realitetit:
formimi i ndërmarrjeve të
reja publike lokale në Kosovë

12/2023



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies

 INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

